



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
Kuvendi

PROJEKT LIGJ

Nr. _____/2019

PËR
DISA NDRYSHIME DHE SHTESA NË LIGJIN NR. 10304, DATË 15.7.2010 “PËR
SEKTORIN MINERAR NE REPUBLIKËN E SHQIPËRISË”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI

I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Në ligjin nr. 10304, datë 15.07.2010 “Për sektorin minerar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

Neni 1

Titulli i seksionit të dytë të kreut IV ndryshohet si vijon:
“Autorizimi i tregtimit dhe veprimtaritë studimore projektuese”

Neni 2

Neni 33 ndryshohet si vijon:

“Neni 33

Veprimtaritë studimore-projektuese

1. Veprimtaritë studimore-projektuese në fushën minerare mund të kryhen vetëm nga persona fizik ose persona juridikë, që kanë të punësuar persona të certifikuar në veprimtarinë studimore-projektuese në fushën minerare. Subjektet detyrohen të regjistrojnë në regjistrin tregtar si objekt veprimtarie kryerjen e veprimtarive studimore projektuese në fushën minerare.
2. Çertifikohen për kryerjen e veprimtarive studimore-projektuese në fushën minerare personat që kanë aftësi teknike dhe përvojën e nevojshme për kryerjen e këtyre veprimtarive.

3. Këshilli i Ministrave, me propozimin e ministrit përgjegjës për minierat, miraton procedurën, kategoritë, kushtet, kërkesat e kualifikimit dhe të eksperiencës profesionale për personin, të cilit i lëshohet certifikata e përcaktuar në pikën 1, të këtij neni”.

Neni 3

Licencat aktuale për kryerjen e veprimtarive studimore-projektuese ruajnë vlerën e tyre.

Neni 4

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

K R Y E T A R I

GRAMOZ RUÇI